



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:078817

Datë: 03.11.2022

Numri i dokumentit: 03605496

NË EMËR TË POPULLIT

PKR.nr. 82/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri dhe anëtarët e trupit gjykues – gjyqtarët Sami Sharaxhiu dhe Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit J. K. për shkak të veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.121/22 të dt. 28.04.2022, mbajti seancën publike të shqyrtimit gjyqësor me datë 07.10.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të pandehurit J. K., me dt.10.10.2022 mori dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.03.11.2022, përpiloi këtë merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

J. K., i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në ..., me vendbanim në fsh. ... Rr. “....”, p.nr., K. P., me l.nj.nr....., ka të kryer Fakultetin Juridik, me profesion-përmbarues në zyrën “....”, i martuar, baba i dy fëmijëve, posedues i nr. tel....., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 25.03.2022, rreth orës 13:30 ne rr.”Bill Klinton” K- Pejë, në kundërshtim me nenin 22 par 2 dhe 3 të Ligjin për Armë (Ligji Nr.05/L-022), bart pistoletën e modelit “S. S”, model .-..., me nr. Serik #..... dhe një (1) karikator të të njëjtës pistoletë, në atë mënyrë që ditën e lartcekur përderisa i pandehuri ishte në lokalin “D. L. B” i cili gjendet në vendin e sipërshënuar të njëjtit i vërehet pistoletë e përshkruar si me lartë e vendosur në brez dhe me të marr informatën policia, të njëjtit verifikojnë informatën dhe dokumentacionin e prezantuar për pistoletën nga i pandehuri mirëpo konstatohet se i e njëjti nuk përkon me dispozita ligjore të lartcekura, me ç ‘rast të njëjtat sekuestrohen nga policia si dhe njëzetë e katër (24) fishekë kalibër 9.19 mm. dorëzohen dhe sekuestrohen nga i pandehuri e të cilat i kishte në posedim në shtëpinë e tij.

- me çka ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind)euro, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim, për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor në shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par 3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet pistoleta e modelit “S. S”, model .-...., me nr. Serik #....., një (1) karikator si dhe njëzetë e katër (24) fishekë kalibër 9.19 mm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/L.nr.121/22 të dt. 28.04.2022, ndaj të pandehurit J. K. për shkak të veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 07.10.2022, ka mbajtur seancën publike të shqyrtimit gjyqësor, ku prezent ishin prokurori i shtetit, Lumturije Vuçetaj dhe i pandehuri J. K..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar provat materiale, si raporti i oficerit E. L #.., i dt. 25.03.2022, raporti informues nga rreshteri F.B, #... i dt. 25.03.2022, deklarata e të pandehurit J. K., e dhënë pranë stacionit policor me dt. 25.03.2022, si dhe në prokurori me dt. 26.04.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i dt. 25.03.2022, fotografitë të realizuara nga policia mbi dokumentacionin për armë si dhe mbi armët dhe pjesët përcjellëse të sekuestruara ditën kritike, aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës nën shenjën Pml.nr.41/21, i dt. 03.03.2022, raporti mbi ekzaminimi balistik nga AKF-ja me nr.-...-..., i dt. 31.05.2022 si dhe është dëgjuar mbrojtja e te pandehurit.

I pandehuri në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike rreth orës 13:00 afër 14:00, ka shkuar me ngrënë drekë tek lokali siç përshkruhet në kallzim penal, kjo nuk është kohë e drekës sepse pauzën e ka nga ora 12:00-13:00, pasi që është përmbaresh privat, dhe gjithmonë e shfrytëzon pauzën 12:00-13:00. Meqenëse ka qenë ditë e premte, e xhuma, zakonisht i pandehuri thotë se e falë namazin e xhumasë, e me qëllim para se me shku në poligonin B..afër

kampit K, ka shku me dreku sepse e ka ditur, me vetëdije të plotë se nuk mund të ketë shumë njerëz në atë lokal si në kohë të pazës. Ka shkuar e ka zënë një pozicion afër murit, respektivisht nga ana e djathtë e tija. Veshur ka pas jaknën e cila ka qenë përfundi belit te tij. Arsyeja pse ka vëpru kështu ditën kritike, është që në bazë të ligjit për armë dhe rregullores 04/2012 të MPB-së, në të cilën thuhet decidivisht “ arma nuk duhet të shihet nga qytetarët sepse mund të ndjell frikësim apo panikë, po ashtu në këtë rregullore thotë arma nuk duhet të jetë e ekspozuar”, duke i pas parasysh të gjitha këto ditën kritike i pandehuri është munduar me i respektu edhe ligjin edhe këtë rregullore. Përfundimisht për atë ditë ka qenë vetëm i pandehuri duke dreku dhe stafi në atë lokal dhe pas tij në një tavolinë rastësisht ka qëlluar polici Faton Berisha, i njëjti meqenëse ka qenë në afërsi 2 metra, e ka vërejt pak tytën e armës sepse jaknja kishte kaluar mbi të. Ka shtuar se është shumë i vetëdijshëm se e ka pas armën në brez, ashtu ka vepruar edhe 5 apo 6 herë më parë, mirëpo gjithmonë duke e mbuluar armën. Përfundimisht vetëm polici civil që ka qenë aty prezent e ka pa armën dhe i eshët afruar për ta legjitimuar dhe e ka pyet rreth armës. I pandehuri ka deklaruar se është i vetëdijshëm për ligjin e armës por ditën kritike e thekson edhe një herë arsyeja që e ka barte në brez armen është se meqenëse ditën kritike ka qene duke lëvizur me kolegun e tij ne relacionet P., P., L. për mos me marr armen me koferin e saj për arsye qe te mos ngjalle kureshtjen tek kolegu e ka marr ne breze dhe se sipas lejes qe posedon i pandehuri thotë se ka te drejt te lëviz nga poligoni në relacionin të cilat janë shënuar në librezë, e armën ta lë në një vend të caktuar respektivisht në veturën e tij. Në fund i pandehuri ka deklaruar se nën betim se asnjëra nga elemente e përgjegjësisë penale, duke përfshirë fajësinë, nuk e ka pas as dashjen në asnjë mënyrë si formë e fajësisë.

Prokurorja e shtetit ne fjalën përfundimtarë ka deklaruar se, pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe mbrojtjes së të pandehurit të dhënë pranë kësaj gjykate u vërtetua se i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me detyrimet që dalin nga rregullat për bartjen e armës e të cilat sipas lejeve që i njëjti i ka pas në posedim nuk e kanë të lejuar bartjen e armës në ambiente tjera përveç vendbanimit deri në poligon. Andaj i pandehuri i vetëdijshëm për obligimet që dalin nga bartja e armës në mënyrë të duhur, ditën kritike ka vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara sipas ligjit mbi armë, duke e vënë armën në brez dhe duke shkuar në restorant , duke ekspozuar dhe me ç ’rast është vërejtur nga ana e të pranishme dhe një gjë të tillë të njëjtin e bën penalisht përgjegjës për veprën penale për të cilën është akuzuar meqenëse në veprimet e tij është realizuar elementi subjektiv dashja direkte për të vepruar siç është përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës. Po ashtu nëse i referohemi aktgjykimit të gjykatës supreme e cila është pjesë e shkresave të lëndës i cili decidivisht ka përcaktuar se bartja e armës në këtë mënyrë manifeston të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale nga neni 366 të KPRK-së, andaj mbi bazën e të lartcekurave i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në paguarjen e shpenzimeve procedurale dhe njëkohësisht të konfiskoj armën me të gjitha mjetet përcjellës dhe të urdhërojë shkatërrimin e të njëjtave.

I pandehuri J. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, nuk ka tjetër çka të shtoj, e kundërshton fjalën përfundimtare të prokurores, tek pjesa ku e njëjta deklaroi se e ka ekspozuar me dashje direkte, sepse i njëjti gjithnjë është munduar që të mos ekspozoj armen. Kjo gjë vërtetohet edhe nga fakti që edhe më parë 5 -6 hera tjera ka vepruar njëjtë dhe askush nuk e ka vërejtur. Kërkon nga gjykata që ta shpall të pafajshëm.

Gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në paragrafin 1 të këtij neni është paraparë që “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.”.

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e të cilat prova nuk ishin kontestuese as për të pandehurin, pasi që edhe vetë i pandehuri në deklaratën e tij të bëra gjatë shqyrtimit gjyqësor e pranon faktin se ditën kritike ka shkuar tek lokali i lartcekur për të drekuar dhe se më vete e ka pasur armen e të cilën e ka mbajtur në brezë. I pandehuri veprimet e veta i arsyeton në atë se ka lejen për mbajtjen e armës dhe se gjatë mbajtjes së armës në brezë nuk e ka ekspozuar dhe e ka mbajtur të fshehtë nën jaknë derisa ka drekuar në një lokal të quajtur “D. L. B” e që pastaj qëllimi i tij ka qenë të shkojë në poligon e të gjuaj.

Gjykata vlerësoi se në veprimet e të pandehurit manifestohet dashja për kryerjen e veprës penale e cila manifestohet përmes elementit subjektiv i cili vërtetohet përmes veprimeve objektive të të pandehurit e që në rastin konkret ndërlidhet me faktin se i pandehuri kishte pasur njohuri se lejohet ekskluzivisht bartja e armës prej vendbanimit të tij e deri në poligonin për qitje dhe anasjelltas dhe jo në ambiente tjera. I pandehuri pafajësinë e tij mundohet ta arsyetojë me faktin se ka marrë masë që arma mos të ekspozohet, dhe se ka shkuar në lokalin e lartë cekur në kohën kur në atë lokal ka frekuentim me të vogël të klientëve. Gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurit janë manifestuar të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ofroi ndonjë provë për të vërtetuar pafajësinë e tij pasi që gjykata vlerësoi se i njëjti ka qenë në dijeni se armën nuk mund të bartet në ambiente të tjera.

Gjykata me propozimin e prokurorisë së shtetit ka administruar si provë edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml.nr. 41/2021 të dt. 03.03.2021, mirëpo gjeti se i njëjti aktgjykim i përkiste një rasti tjetër dhe nuk i përkiste rastit konkret ndaj të pandehurit J. K., andaj si i tillë nuk është provë që vërteton fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit J. K., duke pas parasysh faktin se aktgjykimi i përket çdo rasti konkret dhe nuk mund të merret si burim formal që mund të shërbejë për raste të njëjta apo të ngjashme penale.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë Gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementët e veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtonin përgjegjësinë penale të pandehurit, i njëjti është penalisht përgjegjës, andaj të pandehurin e shpalli fajtor si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana lehtësuese ndaj të pandehurit gjykata mori faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, dhe ndaj tij, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale

të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedurë e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par. 3 te KPRK-së, te pandehurit iu konfiskua pistoleta e modelit “S. S”, model .-...., me nr. Serik #....., një (1) karikator si dhe njëzetë e katër (24) fishekë kalibër 9.19 mm.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda,
PKR.nr.82/22 dt. 03.11.2022.**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i Trupit Gjyqësor
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.